



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 322 prot.

Tiranë, më 22.02.2019

VENDIM

Nr.14, datë 22.02.2019

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 54, DATË 30.05.2018, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË PUSTEC**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 54, datë 30.05.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pustec dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin nr. 75 (749 prot.), datë 03/10/2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 54, datë 30.05.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Pustec.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit nr. 99, datë 25.04.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Pustec”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pustec.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Pustec raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr.54, datë 30.05.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, në detyrat e lëna për Bashkinë Pustec, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë dhe pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

➤ Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në **pikën 2 të tij**, është lënë detyrë që njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me strukturat e tjera administrative të ngarkuara nga ligji (*eprori direkt*), të fillojnë procedurat për rivlerësimin e statusit të pozicioneve të punës “*Specialist i Hartimit të Projekteve TSKM*”, “*Specialiste për Invalidët e Punës dhe PAK në Sektorin e Kujdesit dhe Shërbimeve Sociale*” dhe “*Specialist i Turizmit dhe Kapiten Anije*”, pasi të analizohen dhe të përcaktohen qartë funksionet që ato kryejnë, nëse janë funksione publike apo funksione të karakterit mbështetës (*punonjës administrativ*).

Për pozicionet e punës që do të trajtohen si pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me analistin e punës dhe eprorin e tij direkt, të hartojë përshkrimet e punës në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil për të gjitha pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, duke pasur parasysh aktin nënligjor që rregullon përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës Vendimi nr. 142/2014, i Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i veprimeve të kryera në zbatim të kësaj detyre, konstatoj se janë kryer procedurat e rivlerësimit të statusit të pozicioneve të punës “*Specialist i Hartimit të Projekteve TSKM*”, “*Specialiste për Invalidët e Punës dhe PAK në Sektorin e Kujdesit dhe Shërbimeve Sociale*” dhe “*Specialist i Turizmit dhe Kapiten Anije*”, duke bërë saktësimin e pozicioneve të cilët kanë karakteristikat e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të

përfshira në strukturën aktuale, duke ndjekur orientimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

Nga këqyrja e strukturës aktuale të Bashkisë Pustec dhe Vendimit nr. 59, datë 23.07.2018, të Këshillit të Bashkisë, “Për ndryshimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Pustec”, vërej se për pozicionet e përmendura më sipër është bërë rivlerësimi për statusin që duhet të kenë në raport me shërbimin civil.

Gjithashtu konstatoj se, në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil dhe në zbatim të aktit nënligjor që rregullon përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës (vendimi nr. 142/2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar), njësia përgjegjëse në bashkëpunim me analistin e punës dhe eprorin e tij direkt, ka hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës që përfshihen në shërbim civil, dhe një kopje e tyre e nënshkruar është bërë pjesë e dosjes së personelit për çdo punonjës.

➤ Në **pikën 3** të vendimit paralajmërues është lënë detyrë që për nëpunësit të cilët janë në periudhë prove, me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore gjatë periudhës së provës, eprori direkt i nëpunësve dhe aktorët e tjerë që marrin pjesë në këtë proces, të respektojnë të gjitha kërkesat specifike ligjore, si dhe orientimet e përcaktuara në rubrikën **V**, të Raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, “Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga grupi i punës gjatë verifikimit në subjekt, konstatoj se, nga ana e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësve përgjegjës për finalizimin e procesit të periudhës së provës janë ndërmarrë të gjitha hapat deri në nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për 6 nëpunësit të cilët, në momentin e mbikëqyrjes së përgjithshme, u gjenden në periudhë prove (evidentuar në rubrikën **V** të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes).

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes në vazhdimësi, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 54, datë 30.05.2018, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pustec dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Pustec, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 54, datë 30.05.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Pustec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha